



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 547, datë 05.11.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z.SOKOL PINA, NË GJYKATËN E APELIT GJIROKASTËR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. Sokol Pina caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për periudhën deri më datë 05.11.2021.
2. Gjyqtari në skemën e delegimit z. Sokol Pina përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykata e Apelit Gjirokastrë, për periudhën deri më datë 05.12.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet Gjyqtari në skemën e delegimit z. Sokol Pina, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR